

3.06.1998. U varros së pari në Pobërgjë/ Pobrđe. Më pas, mbetjet e tij mortore u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Irzniq/Rznić, më 11.09.1999.

Burimet: J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.

Tixhe (Sadri Zekaj) Tolaj

(1930, shqiptare nga Lloqani/Loçane, komuna e Deçanit/Deçani, amvise)

Pas sulmit të forcave serbe [29.05.1998], anëtarë të rinj të familjes Tolaj e kanë braktisur fshatin Lloqan/Loçane, ndërkaq në shtëpi kanë mbetur vetëm katër anëtarë të moshuar: Tixhja, bashkëshorti i saj Haliti me dy vëllezër të tij, Muratin dhe Haxhiun. Disa ditë më vonë, më **4.06 1998**, një grup policësh serb erdhi te shtëpia, duke kërkuar që të moshuarit të nisën me ta për në Deçan/Deçane, me qëllim strehimin e tyre në qytet. Haliti, Murati dhe Haxhiu u nisën me policët serbë, ndërkaq Tixhja e moshëthyer refuzoi duke ndenjur në shtëpi [**Lloqan/Loçane**]. Nga ajo ditë nuk dihet asgjë për fatin e saj. Zhdukja e saj është evidentuar nga KNKK-ja dhe është sistemuar në lëndën me numrin rendor BLG-803279-01.

Burimet: deklarata G.T, FDH-18701; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Jeton (Zeqir) Dabiqaj

(29.01.1975, shqiptar nga Prilepi/Prilep, komuna e Deçanit/Deçani, pjesëtar i UÇK-së)

Jetoni ishte djali më i vogël në familjen Dabiqaj. E mbaroi shkollën e mesme në Deçan/Deçane. Për shkak të dyshimeve për shkuarjet e tij të shpeshta për në Shqipëri për të transportuar armatime në Kosovë, policia e shqetësonte shpesh duke e ftuar për bisedat informative. Për këtë arsye, ai shkoi në Gjermani, ndërkaq më vonë kaloi në Zvicër. Në datën 20.04.1998, Jetoni u kthye në Kosovë dhe menjëherë u paraqit në Shtabin e UÇK-së në Prilep. U plagos në luftimet me forcat serbe në **Prilep** më **4.06.1998**. Bashkëlufëtaret e çuan menjëherë në spitalin e UÇK-së në Irzniq/Rznić, por, një ditë më vonë, ai ndërroi jetë nga plagët e rënda. E kanë varrosur në

fshatin e lindjes.

Burimet: J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; KMDLNJ, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 207, FDH-23816; deklarata D.M, FDH-12488; deklarata J.D, FDH-12486.

Sylë (Ahmet) Himaj

(1912, shqiptar nga Lloqani/Loçane, komuna e Deçanit/Deçani, bujk, tre fëmijë)

Forcat serbe e kanë sulmuar Lloqanin/Loçane më 29.05.1998. E tërë familja e Sylës e braktisi fshatin dhe u strehua në **Voksh/Voksa**. Pas dy ditësh, të gjithë u nisën për në Shqipëri përpos Sylës. Ishte në moshë të thellë dhe nuk desh të shkonte. Ka qenë kjo hera e fundit që familjarët e shihnin të gjallë. Dy muaj më vonë, familja ka dëgjuar nga Sali Hadërgjonaj se Sylja ishte nisur nga Vokshi/Voksa për në Lloqan/Loçane, më **4.06.1998**. Nga ajo ditë, asgjë nuk dihet për fatin e tij. Zhdukja e tij është evidentuar nga KNKK-ja dhe lënda e tij e mban numrin rendor BLG-803272-01.

Burimet: deklarata R.H, FDH-18703; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Brahim (Tafë) Demalijaj

(25.05.1949, shqiptar nga Strellci i Epërm/Gornji Streoc, komuna e Deçanit/Deçani, inxhinier bujqësor, shtatë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Brahimi punonte si inxhinier bujqësor pranë Kuvendit Komunal të Deçanit/Deçane. Aderoi në UÇK më 20.05.1998. Në datën **5.06.1998**, Brahimi u vra në përleshjet e armatosura me pjesëtarët e forcave serbe në fshatin **Strellc i Epërm/Gornji Streoc**. Fshatarët e kanë varrosur në një pyll përkaj fshatit. Pas përfundimit të luftës, më 28.09.1999, UÇK-ja e ka organizuar sërish varrimin e tij në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës, në Strellcin e Epërm/Gornji Streoc.

Burimet: J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.

Leutrim (Esat) Agaj

(22.02.1996, shqiptar nga Gramaçeli/Gramaçel, komuna e Deçanit/Deçani)